



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" për aktivitetin: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni ne Lagjen Vakoc" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-1262-511** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" e datës 18.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rruges nga Flotacioni ne Lagjen Vakoc" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-1262-511** kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 15.08.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Vertetohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.08.2020*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Rahovica Comerc SHPK" ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni ne Lagjen Vakoc" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-1262-511**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 20.08.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi juaj lidhur me çertifikatat për latues dhe armirues është i pa bazuar, pasi që Autoriteti Kontraktues nuk ka pas asnjë kërkesë decizive se nga kush duhet të jenë të leshuara të njejtat dhe për ne çfaredo licence apo çertifikate që e deshmon atë kualifikim për AK-ne është e pranueshme;

-Pretendimi numer 2 poashtu është i pa bazuar pasi që AK-ja ka rekomanduar për dhenje të kontrates një tenderues që i plotëson të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit;

-Pretendimi tjetër lidhur me çmimet jonormalisht të ulta është i pa bazuar, pasi që AK-ja bazuar në dispozitat ligjore ka kërkuar sqarime shtese nga tenderuesit të cilët sipas atyre rregullave janë konsideruar me çmim jonormalisht të ulët dhe këto sqarime janë kërkuar edhe nga tenderuesi i propozuar për dhenje të kontratës,

-Edhe pretendimi vijues është i pa bazuar pasi që personi që ka nënshkruar dokumentacionin është pronar i kompanisë dhe vetëm emri është shënuar sigurisht gabim, pasi që e dini edhe ju që kemi të bëjmë me anëtar të familjes së njëjtit ("Bageri" dhe "Kosova Asphalt"). Në deklaratë shihet qartë se nënshkrimi është i Valdrin Shabanit, i cili në çertifikatën e regjistrimit të biznesit është i paraqitur pronar i kompanisë.

Bazuar në sqarimet paraqitura u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit